



Kërkohej Drejtor Marketingu pranë Federatës Shqiptare të Basketbollit

Federata Shqiptare e Basketbollit, me zgjerimin e aktivitetit të saj me kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare,

shpall thirrjen për aplikim, në pozicionin e Drejtorit të Marketingut (DM).

Personi i përzgjedhur për këtë pozicion, duhet të plotësojë kriteret si vijojnë:

Personat që kanë background basketbollistik, kanë përparësi.

Kriteret e Përgjithshme të DM:

1. Përgatit planin e Marketingut dhe harton strategjinë vjetore të zhvillimit të aktiviteteve dhe organizon e drejton punën për rritjen e të ardhurave të Federatës , harton Planin e Përgjithshëm të Marketingut dhe propozon buxhetin e marketingut bazuar në këtë plan.
2. Është përgjegjës , për imazhin dhe paraqitjen e aktivitetit në media, në rrjete sociale
3. Është përgjegjës për hartimin e strategjisë së fushatave të marketingut (të brendshme dhe të jashtme) për të siguruar efikasitetin maksimale të tyre, peësa i përket brandit/produktit (eventet sportive basketbollistike)
4. Merr pjesë në procesin e zhvillimit të rrjetit; në qytete të ndryshme ku ka shtrirje të aktiviteteve basketbollistike, duke ndjekur politikën e gjithëpërfshirjes në eventet basketbollistike të të gjitha kategorive
5. Merr pjesë në procesin e zhvillimit të produktit/Eventit basketbollistik të shitshëm ndaj publikut, mediave, sponsorëve, grupeve të interesit/komunitetit të basketbollit dhe ndjek ecurene e tyre. Në bazë të rezultateve, sugjeron përmirësime në strategjitë e marketingut të eventeve sportive
6. Ndjek dhe informon antarët për të gjitha eventet e organizuara nga FIBA dhe partnerët e tjerë ndërkombëtare basketbollistike, duke krijuar kontakte dhe shkëmbyer eksperiencë
7. Krijon rrjete lokale dhe kombëtare bashkëpunimi për promovimin dhe mediatizimin e eventeve Basketbollistike
8. Ndjek me përpikmëri programe kualifikimi të ofruara nga FIBA, Liga Unike, Federata të Tjera kombëtare, apo partnerë të tjerë me të cilat FSHB bashkëpunon dhe trajnon në fushën e marketingut, duke shpërndarë informacionin/trajnuar, shoqatat anëtare të Federatës së Basketbollit.



Për të përmbushur detyrat e tij/saj DM:

- manaxhon marrëdhëniet brenda stafit për zhvillimin e marketingut
- manaxhon marrëdhëniet me kompanitë, agjensitë e reklamave dhe furnitorët e ndryshëm, mediat dhe sponsorët
- mban lidhje me përfaqësuesit e shoqatave të basketbollit, dhe organizon trajnime me to anëtare të FSHB-së si edhe autoriteteve lokale
- përgjegjës për sportin, dhe siguron plotësimin e nevojave, të lidhura me ruajtjen e standartit vizual të brendshëm dhe të jashtëm të eventeve basketbollistike.

Profili Individual i dëshiruar:

- Të ketë përfunduar studimet e larta,
- Të ketë marrë pjesë në trajnime në fushën e marketingut
- Njohës dhe ndjekës i mirë i aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare
- Të ketë eksperiencë pune në fushën e Marketingut, në kompani apo institucione, jo më pak se tre vjet
- Kërkojen njohuri marketimi të eventeve sportive, (preferohet basketbollistike)
- Njohuri të mira në marketing dhe komunikim për të përmbushur me efektivitet objektivat

- Krijues, i/e kujdeshëm ndaj detajeve

Personat e interesuar duhet të dergojnë brenda datës 10 Prill 2021:

- Letër motivimi për pozicionin

- CV e detajuar

Në: info.fshb@gmail.com

info@uniqa.al